



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

U R D H Ë R

Nr. 236, datë 13.12.2024

PËR

PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONEVE DHE DETYRAVE TË TYRE,
NË KUADËR TË MEKANIZMIT PËR MBARËVAJTJEN E ZBATIMIT
TË DOKUMENTIT TË POLITIKËS “AGJENDA KOMBËTARE
E REFORMAVE 2024-2027”, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT
TË BASHKIMIT EVROPIAN “FACILITETI PËR REFORMA
DHE RITJE PËR BALLKANIN PERËNDIMOR”

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të vendimit nr.621, datë 10.10.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024 – 2027”, në kuadër të Instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”,

U R D H Ë R O J:


1. Koordinatori Kombëtar për Instrumentin e Paraaderimit të Asistencës Financiare të Bashkimit Evropian (në vijim KKIPA) të ndjekë procedurat për miratimin, në parim, për nënshkrimin dhe ratifikimin e Marrëveshjes së Facilitetit me Bashkimin Evropian, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian, “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”.
2. KKIPA-ja të koordinojë punën me institucionet përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e planit të komunikimit, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”.
3. Ministri i Financave të ndjekë procedurat për miratimin, në parim, nënshkrimin dhe ratifikimin e marrëveshjes së huas, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”.

4. Ngarkohet ministri i Financave dhe Koordinatori Kombëtar për Instrumentin e Paraaderimit të Asistencës Financiare të Bashkimit Evropian për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDIRAMA

A large, stylized handwritten signature in blue ink is written over the text. The signature starts with a long horizontal stroke from the left, then curves upwards and to the right, forming a large loop that encompasses the text 'K R Y E M I N I S T R I' and 'EDIRAMA'. The signature ends with a long horizontal stroke extending to the right.

NR.PROT. 6799
DATE 16.12.2024

MINISTRI TË SHTETIT DHE KRYENEGOCIATOR
MINISTRISË SË FINANCAVE
KOORDINATORIT KOMBËTAR PËR INSTRUMENTIN E
PARAADERIMIT TË ASISTENCËS FINANCIARE TË
BASHKIMIT EVROPIAN

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

